



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA MALIQ
ZYRA ME NJË NDALESË**

Nr. _____ Prot.

Maliq, më: 10.09.2019

Procesverbal

I mbajtur në dëgjuesën publike për Programin Buxhetor Afatmesëm 2019-2021, në Njësinë Administrative Pojan

Në kuadër të Ligjit 139/2015 “për vetqeverisjen vendore”, Ligjit 119/2014, “Për të drejtën e informimit publik”, dhe Ligjit nr. 146/2014, neni 18 “Pjesëmarrja në takime Publike”, u mbajt sot, më dt. 10.09.2018, ora 14:00 në sallën e mbledhjeve të Njesisë Administrative Pojan, takimi konsultativ (dëgjesa publike) mbi Programin Buxhetor Afatmesëm 2019-2021, si dhe për buxhetin vjetor, pjesë e buxhetit afatmesëm.

Në takim morën pjesë: Kryetari i Bashkisë Maliq, z. Gëzim Topçiu, Deputeti i zonës, z. Ilirjan Pendavinji, drejtues dhe specialistë të Bashkisë Maliq, banorë të Njesisë Administrative Pojan, kryetarë të Fshatrave, përfaqësues të bizneseve, shoqatave, si dhe grupe të tjera të interesit.

Në vijim të procesit të hartimit dhe përgatitjes së Programit-Buxhetor Afatmesëm për periudhën 2019-2021, dhe për buxhetin vjetor 2019, takuam dhe dëgjua banorët e Njesisë Administrative Pojan, për të vendosur së bashku prioritetet e investimeve reale, që do të realizohen nga Bashkia Maliq, me qëllim përmirësimin e jetesës në çdo fshat, ku këta banorë jetojnë. Gjatë diskutimit, në thelb të dëgjësave publike ishin, jo vetëm punët dhe investimet e kryera nga Bashkia Maliq gjatë këtyre tre viteve, por dhe kërkesave e nevojave thelbësore në lidhje me përmirësimin e një sërë shërbimesh si ç’janë:

1. Furnizimi me ujë të pijshëm dhe ndriçimi publik në disa fshatra të njesisë, si:

a) Rrëmbec, b) fshati Orman, c) fshati Plasë, d) fshati Gollobërdë, e) fshati Zvezdë.

2. Rehabilitimi dhe sistemimi i rrugëve të brendshme në fshatra si dhe në parcelat bujqësore në fshatin Pojan, Rrëmbec etj.

3. Sistemimi i rrugëve hyrëse në fshatra dhe rrugëve dytësore për në parcelat bujqësore.

4. Rikonstruksioni i ujësjellësave dhe kanalizimeve në fshatin, Gollobërdë

5. Mbyllja e shkkollës në fshatin Pendavinj

6. Asfaltimi i rrugës kryesore në Plasë kur futesh që nga fshati Kuç..

7. Riparimi i linjës së korentit në fshatin Zvezdë.

8. Pastrimi i kanaleve vaditës në fshatrat, Pojan, Rov, Pendavinj etj.

.

Theksi u vendos dhe tek përmirësimi i disa objekteve ,si kopshte ,shkolla ,furnizimi me dru zjarri etj. Takimi u hap me fjalën e Kryetarit të Bashkisë Maliq, e cila u pasua me prezantimin e Programit Buxhetor për periudhën 2019-2021, u bë një analizë e investimeve dhe punëve që janë kryer nga Bashkia Maliq gjatë kësaj periudhe, si dhe u propozua hedhja e ideve dhe mendimeve të banorëve të komunitetit për të përcaktuar prioritetet e investimeve dhe alokimin e fondeve sipas nevojave dhe kërkesave të komunitetit. Pas prezantimit u vijua me komente dhe pyetje të pjesëmarrësve, të cilëve i'u përgjigjën drejtues dhe specialistë të Bashkisë që mbulojnë sektorët përkatës.

Koordinatori për Njoftimin dhe Konsultimin Publik

Stiljan Belishta